



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2020:164098

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05708131

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA DEÇAN, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtar Fatmir Dobraj dhe Bashkëpunëtorin Profesional Arijanit Balaj , në çështjen juridike-kontestimore të paditësit E.I. nga Komuna e G... , të cilin e përfaqëson av. F. B.. nga Peja , kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve P..." me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson L. S... nga Prishtina Baza juridike: kompensimit e dëmit material, Vlera e kontestit: 2.000 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur në prani të autorizuarit të paditësit dhe autorizuarit të paditurit, e të përpiluar me datë: 02/05/2024, bie këtë:

AKTGJYKIM

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit E.I. nga Komuna e G.... .

- I. DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve "Prissig", 10000 Prishtinë, qe paditësit ne emër të kompensimit të demit material në veturë në shumën prej 1612,12 (njëmijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë euro pik dymbëdhjetë centë), me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 13/11/2020 (data e paraqitjes së padisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
- II. OBLIGOHET** , e paditura që paditësit në emër të përfaqësimit t'ia paguaj shumën 775.2 euro gjitha këto ne afat prej 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi , e nen kërcënim përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 13/11/2020, kundër të paditurës për kompensim dëmi.

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se : mbesë pranë padisë dhe kërkesës se saj respektivisht precizimit të kërkesëpadisë me dt. 11/04/2024 duke theksuar se nga provat e administruara gjatë seancave është vërtetuar në tërësi baza juridike e kërkesë padisë , ndersa lartësia e kërkesë së padisë së precizuar është proporcionale me ekspertizën, andaj propozojmë gjykatës që të njëjtën të aprovojë ne tërësi .

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar .

Përfaqësuesi i të paditurës gjatë shqyrtimit gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se : se nuk e kundërshtojmë bazën juridike të pergjegjësisë , mirëpo e kundërshtojmë lartësin e kërkuar për demin material , lidhur me precizimin e berë , Andaj kërkojmë nga gjykata që padinë dhe kërkesën e saj ta aprovoj pjesërisht si të bazuar. Si dhe sa i përket shpenzimeve të procedurës të aprovoj bazë suksesit të procedurës.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike ka administruar me këto prova leximin e lejes së qarkullimit e datës 05.09.2020,raporti i aksidentit 2020DC 321,1deri 2 faqe leximin e ekspertizës se komunikacionit e dt.15.04.2021 ekspert Ylli Koshi .leximin e procevrbalit ë vendishiqimit të aksidentit ,i dhe provat të bashkëngjitura 1 deri ne 23 .leximin e aktgjykimit me nr. K.nr 173/20 dtaes 15.07.2021 i formës së prerë me datën 01.10.2023.

Leximin ekspertizes se komunikacionit dt.12.02.2024 e ekspertë Fisnik Qavolli Leximin e ekspertizës se makinerisë e dt.05.03.2024 eksperti Afrim Kuqi Leximin e ekspertizës makinerisë e dt.08.04.2024 të eksperti Naser Lajqi si dhe sqarimin ne seancë.

Pasi administrimit të provave dhe vlerësimit nga ana e Gjykatës, të secilës provë veç e veç , e në lidhshmëri me njëra- tjetrën, çmuarjes me kujdes dhe ndërgjegje, si dhe duke mbështetur dispozitën e nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se në rastin konkret duhet vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Faktet .

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se kishte ndodhur aksident me dt. 31/10/2020, ku kjo verhet nga raporti i policisë me numër DR-2020-DC-321 i datës 31/10/2020 i cili kishin konstatuar se deri të aksidenti ku paditësi po udhëtonte si pasagjer në automjetin e markës WV me targa 03-604-FK, me pronar M... H...i siguruari tek e paditura. Ku deri tek aksidenti kishte ardhur , për shkak se shoferi i autobiesit ka leshuar shiritin e djathtë kalon ne shiritin e majtë dhe godet veturën e paditësit ne pjesen e derës se pasme në të djathtë dhe në atë moment vetura B e humb kontrollin nga goditja me pjesen e parme e godet veturën C në pjesen e pasme e cila vetur ka qene e parkuar në anenë e djathtë të rrugës ne menyre jo të rregullt . Si pasoj e aksidentit të tre automjetet pësojnë dëme materiale , si dhe lëndime trupore shoferi i veturës “B”.Për gjykatën nuk ishte kontestuese se automjeti të cilin e drejtonte Sami Mazrekaj ka qene e siguruar të Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese baza juridike por lartësia e vlerës se dëmit të pësuar.

Andaj gjykata edhe pse nuk ishte kontestsuese baza,për të nxjerrur bazën juridike të pergjegjësisë ka shikuar ekspertizën e komunikacionit e nxjerrur në procedurën Kundërvajtje , nga eksperti Yll Koshi i cili në ekspertizën e tij ka deklaruar se : Shkaktar i këtij aksidenti janë të dy pjesëmarrësit në këtë aksident , shoferi i autobusit “A” dhe shoferi i veturës “B” me lëshimet e tyre .

Ku lëshimet e shoferit “A” kanë qene ndërrimi i pasigurt i shiritit të trafikut nga i djathti në drejtim të majtin me qëllim të anashkalimit të veturës “C” të parkuar në anenë e djathtë të rrugës , duke mos verifikuar se a ka mjete tjera ne shiritin në të cilin tentonte të kalonte , ku në afërsi

në atë shirit prapa tije ishte duke lëvizur veturën “B” e markës WV Passat ku e detyron shoferin e saj të frenoj dhe të humb kontrollon mbi mjet i cili goditet me autobus dhe pastaj humbjes së kontrollit vetura “B” përplasat në pjesen e prapme të veturës.

Gjykata sipas propozimit ka nxjerrur ekspertizën e Komunikacionit nga eksperti Fisnik Qavolli i cili në mendimin e tije përfundimtar ka deklaruar lidhur me aksidentin : Aksidenti ka ndodhur ne rrugën “Dëshmoret e Kombit” në D.... (zonë Urbane), kufizimi i shpejtësisë së lëvizjes është 40 km/h, në kohën e ndodhjes së aksidentit dukshmëria ka qene ditë , qarkullimi është rregulluar me shenja trafiku , kontakti në mes autobusit A dhe automjetit B është ne shiritin e majtë qarkullues (shikuar ne lëvizjen e automjetit B pas kontaktit me autobusin A), drejtuesi i automjetit B ka lëvizur me shpejtësi prej 81.54 km/h, ku kufizimi i shpejtësisë është 40 km/h, për shpejtësinë të lejuar prej 40 km/h, drejtuesi i automjetit B ka mundur të shmang kontaktin me autobusin A”.

Gjykata për të nxerru lartësin lidhur me demet materiale të pësura sipas propozimit të palës paditëse ka nxjerrur ekspertizë të makinerisë nga eksperti Afrim Kuçi , i cili në konstatimin e tij përfundimtar ka deklaruar se vlera e përgjithshme dëmit në automjet si rezultat i këtij aksidenti është 2,428.20 euro , ndersa pas kontestimit nga ana e paditurës ,dhe sipas propozimit të palës paditur gjykata ka nxjerrur ekspertizën tjetër të makinerisë pas kërkesë se tyre të paraqitur në këtë gjykatë ku është caktuar eksperti Dr. Naser Lajçi i cili në konstatimin e tij përfundimtar ka deklaruar se demet materiale të pësura në automjet kapin vlerën prej 2,016.0 euro . Ku edhe në seancë ka mbetur pranë konstatimit të tij të dhëne me ekspertiz.

Ligji i Aplikueshëm :

Ligji për Marrëdhëniet Detyrimeve : Në nenin 136 parg. 1 të LMD-së parashihet që: *“kush tjetrit i shkakton dëm ka për detyrë ta kompensojë atë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*.Neni 137 të LMD-së ku thuhet se: *“ dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi i tjetrit dhimbje fizike, vuajtje psikike ose frikës (dëmit jo-material)”*.Dispozita e nenit 140 të LMD-së i” Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”. Ndërsa me nenin 159 të po këtij ligji është paraparë se *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit.”*.Neni 169 parg. 3 të LMD-së ku thuhet se: *“kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës gjykata do të caktojë që ai t’ ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.* Neni 173. Par 1 *“I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur”,neni 176 “I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar”*.Gjykata po ashtu në bazë të Ligjit procedurës Kontestimore në nenin 14 i cili thotë *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”* Andaj gjykata

duke bazuar ne vendimin nga Gjykata Themelore Pejë Dega në Deçan Divizioni Kundërvajtje me numër K-Nr.173/2020 i datës 15/07/2021 i plotfuqishëm me dt.01/10/2021.

Sipas nenit 323 të LPK-së, është paraparë se *“po qëse vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi ne të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendos sipas çmuarjes së lirë të saj”*.

Në bazë të nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Gjykata pas analizimit të gjendjes faktike dhe juridike ka ardhur në përfundim se duhet të vendoset që të aprovohet tërësi padia dhe kërkesë padia si në pikën I dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Deri të aksidenti ka ndodhur me dt.31/10/2020 rrethe orës 06:00, ku si pasoj e lëvizjes së autobusit nga ana e djathë në anën e majtë të shiriti pa siguruar mirë se mund të bejë lëvizjen të pa penguar në rrugën D... afër qendre B... , atë moment ka qene ne lëvizje automjeti passat ku gjatë lëvizjes në pamundësi reagimi godet autobusin dhe me këtë vetura B godet veturën C e cila ishte e parkuar në trotuar që ishte pronë e paditësit , lidhur me shumën e aprovuar gjykata vlerësojë me kujdes të dy ekspertizat e komunikacionit , të cilat në mendimet e tyre profesionale kishin konstatuar se vetura “C” ishte parkuar në menyre jo të rregullt, ku sipas gjykatës ne rastin e vlerësimit të dëmit dhe shpërblimin e saj vjen ne përfundim se kontributi i vetë paditësit ne këtë aksident ishte 20 % për shkak të parkimit jo të rregullt të veturës . Andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën e përgjegjesisë së paditurës si 80% , ndersa paditësit përgjegjës 20% , e duke u mbeshtetur ne nenin 176 par 1. “I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar.”

Ketë gjykatë e analizoje dhe ja fali besimin ekspertizës së ekspertit Naser Lajqi,e cila ekspertizë ishte ne harmoni me provat dhe dëmin e shkaktuar dhe e nxerrur ne menyre profesionale.Ndersa ekspertizës të komunikacionit ju fali besimin ishte ne harmoni me provat dhe veprimet e pjesëmarrësve ne komunikacion dhe e nxerrur ne menyre profesionale.

Ndersa sa i përketë asaje së pse i autorizuari i paditësit ka kërkuar shume qe të i aprovohet në tersi,ketë fakte gjykata e analizoje,dhe ate sipas precizimit si në procevrable të datës 11.04.2024,ku ka thenë shuma të jetë 1612.12 euro ,ndersa sa i perketë ekspertizës së makinerisë Naser Lajqi,e ka dhen përfundimin ne shumë prej 2016 euro .Dhe më këtë ekspertizë pala paditur hynë ne detyrim ne shumen e cekur si me lartë,por kërkesa ishte duke e bazuar ne përgjegjësia e të paditure pasiqe përgjegjsia ishte e ndarë.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen e vertetuar faktike si me lartë,i mori prasysh edhe pretendimet e ngritura nga i autorizuari e palës se paditure të cilë në fjalën përfundimtare ka aludur se në rastin konkret është kontestuese lartësia e kërkesëpadisë si ne rastin konkret.Mirëpo për gjykatën

pretendimet e përfaqësuesit të paditues ish jo relevantë për vendosje ndryshe pasi që paditësi gjatë shqyrtimit kryesor me prova të prezantuar dhe të administruar gjykatës ia ka bërë të besueshme bazën dhe lartësin e kërkesëpadisë si për pjesën e aprovuar si ne bazë të dispozitave ligjore, si ne dispozitiv. Andaj nga të cekurat e beri të bazuar kërkesën pala paditëse dhe u vendose si ne dispozitivë .

Lidhur me kamatën konform shumave të aprovuara për kompensim të dëmit material dhe jo material gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin neni 382 të LMD-së, ku thuhet se: “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën si dhe lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Me rastin e vendosjes për shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata ka vendosur konform dispozitave 452 par.2 të LPK-së ku thuhet se: “Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve, Andaj gjykata ia njohu shpenzimet e procedurës prej 775.2 euro , duke vlerësuar se sukcesi i procedurës ka qene ne vlerë prej 80% të suksesit të procedurës. Nga të lartcekurat vendosin si në dispozitiv.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA DEÇAN, me dt. 02/05/2024

G j y q t a r i
Fatmir Dobraj

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, të këtij Aktgjykimi, e përmes kësaj Gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.